

Tiranë, më 31.10.2019

Lënda: Shtojcë për modifikim në dokumentat e tenderit

Objekti i Prokurimit: “Blerje e nje Autotransformatori te ri 300 MVA, 400/230 kV per N/ST Tirana 2”

Mbështetur në Nenin 42, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe në Nenin 62, të VKM-së Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Njësia e Prokurimit, referuar ankesës se bërë nga Operatorët Ekonomik, pas perfundimit të afatit të ankimimit kunder vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, si dhe rekomandimeve të APP-se, bën ndryshimin e dokumenteve standarde të tenderit, për procedurën “E hapur mbi kufirin e larte monetar” - me mjete elektronike - Mallra, me objekt “*Blerje e nje Autotransformatori te ri 300 MVA, 400/230 kV per N/ST Tirana 2*”, me fond limit 293,279,980 (dyqind e nentëdhjetë tre milion e dyqind e shtatëdhjetë e nente mijë e nentëqind e tetëdhjetë) Lekë pa TVSH, si me poshte:

I- Tek DST (versioni Shqip) tek kriteret e vecanta te kualifikimit (Shtojca 9) pika 2.1

ISHTE

2.2.1 Ne permbushje te kapacitetit ekonomik dhe financiar operatori ekonomik ofertues duhet te kete realizuar xhiro mesatare vjetore, gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit te tenderit, në një vlerë te pakten prej 293,279,000 (dyqind e nentëdhjetë e tre milion e dyqind e shtatëdhjetë e nente mijë) lekë.

Operatorët ekonomik qe kane aktivitet me pak se 3 (tre) vite, duhet te kene xhiro mesatare nga data e zhvillimit te tenderit, ne vleren e kerkuar te pakten prej 293,279,000 (dyqind e nentëdhjetë e tre milion e dyqind e shtatëdhjetë e nente mijë) lekë.

Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e siperpermendura ose kopje të certifikuara të bilanceve.

BEHET

2.2.1 Ne permbushje te kapacitetit ekonomik dhe financiar operatori ekonomik ofertues duhet te kete realizuar xhiro mesatare vjetore, gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit te tenderit, në një vlerë te pakten prej 117,311,600 (njëqind e shtatëmbëdhjetë milion e treqind e njemëdhjetë mijë e gjashtëqind) lekë.

Operatorët ekonomik qe kane aktivitet me pak se 3 (tre) vite, duhet te kene xhiro mesatare nga data e zhvillimit te tenderit, ne vleren e kerkuar te pakten prej 117,311,600 (njëqind e shtatëmbëdhjetë milion e treqind e njemëdhjetë mijë e gjashtëqind) lekë.

Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e siperpermendura ose kopje të certifikuara të bilanceve.

II- Tek DST, (versioni Shqip + Anglisht) kriteret e vecanta te kualifikimit (Shtojca 9) pika 2.3.3

ISHTE

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese certifikaten, qe verteton qe sistemi I menaxhimit te cilesise se tij eshte sipas standartit ISO 9001:..

BEHET

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese certifikaten, qe verteton qe sistemi I menaxhimit te cilesise se tij eshte sipas standartit ISO 9001:..

Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH”.

III- Tek DST, (versioni Shqip + Anglisht) kriteret e vecanta te kualifikimit (Shtojca 9) pika 2.3.4

ISHTE

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese certifikaten, qe verteton qe sistemi I menaxhimit te sigurise ne pune eshte sipas standartit OHSAS 18001:..

BEHET

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese certifikaten, qe verteton qe sistemi I menaxhimit te sigurise ne pune eshte sipas standartit OHSAS 18001: ose ISO 45001:2018.

Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH”.

IV- Tek DST (versioni Shqip + Anlisht) Specifikimet Teknike (Shtojca 10) Pika 20 e tabelës të dhënave teknike për Autotransformatorin tre fazor 400/230 kV, 300 MVA

ISHTE

Tensioni reaktiv në pozicion 25 kyçje tensioni (460/230 kV)

BEHET

Tensioni reaktiv në pozicion 25 kyçje tensioni (340/230 kV)

V- Tek DST (versioni Shqip + Anlisht) Specifikimet Teknike (Shtojca 10) shtohen

1. Vizatimi i AT egzistues
2. Shenimet:
 - a. Në të gjithë rastet kur përmendet “markë” përfshihet termi “ekuivalente”.
 - b. Operatoreve Ekonomik qe kane interes per te marre pjese ne kete procedure prokurimi,

AK ju mundeson nje vizite ne N/Stacionin Tirana 2, ku do te instalohet AT, ne daten 15.11.2019 ora 10:00.

VI- Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje shtyhet nga data 22.11.2019, ora 10:00 në datë 09.12.2019, ora 10:00..

Njesia e Prokurimit